



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### NJOFTIM PËR VENDE TË LIRA PUNE

#### ***Kontrolli i Lartë i Shtetit shpall konkursin për vende të lira pune:***

##### **I. Për 1 (një) vend në pozicionin e Drejtorit/Kryeaudituesit të Departamentit.**

##### **-Kërkesat për kandidatët e këtij vendi pune janë:**

- Të kenë kryer arsimin e lartë dhe të jenë diplomuar në Fakultetin Inxhinieri Miniera.
- Të kenë kryer studimet master në Administrim Biznesi.
- Të kenë eksperiencë pune në fushën e diplomimit.
- Të zotërojnë gjuhën angleze dhe një gjuhë të dytë të huaj të një prej vendeve të BE-së.
- Të kenë aftësi të mira menaxhuese dhe komunikuese.

Paga mujore për këtë vend pune është në nivelin e pagave të shërbimit civil.

##### **Përshkrimi i punës**

Përgjigjet dhe jep llogari për veprimtarinë e departamentit dhe ecurinë e zbatimit të detyrave të ngarkuara para Kryetarit dhe para Sekretarit të Përgjithshëm/Drejtorit të Përgjithshëm. Jep mendime dhe përgjigjet përpara Kryetarit për cilësinë e auditimeve. Përgatit për miratim programet vjetore të auditimit mbi bazën e një konsulte të gjerë me audituesit dhe ndjek zbatimin e programeve mujore të auditimit, duke raportuar periodikisht për realizimin dhe problematikën e tyre. Organizon, drejton dhe mbikëqyr zbatimin e programeve të auditimit, duke e shoqëruar me analiza e raporte, nxjerr përfundime për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë audituese të departamentit. Ndjek drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet kryeaudituesit dhe përgjegjësit të grupit të auditimit, ecurinë e veprimtarisë audituese, duke udhëzuar dhe këshilluar grupet e auditimit për realizimin me cilësi dhe efektivitet të auditimeve. Raporton te Kryetari i KLSH-së mbi ecurinë, realizimin e programit, shkeljet e zbuluara dhe probleme të tjera të mbarëvajtjes së punës audituese çdo 10 ditë dhe jo më pak se tre herë për çdo auditim. Ndjek përgatitjen e projektraporteve dhe raporteve të auditimit, projektvendimeve dhe vendimeve përkatëse. Organizon dhe ndjek evadimin në afat të materialeve të auditimit, duke ia paraqitur konform rregullave Kryetarit për shqyrtim e miratim. Bashkëpunon dhe bashkërendon punën me strukturat e tjera të institucionit për detyrat që i ngarkohen nga Kryetari. Sipas planit të auditimeve dhe urdhrave të Kryetarit, organizon auditime të përbashkëta me departamentet e tjerë dhe ndjek ecurinë e tyre. Kryen detyra të tjera të veçanta që i ngarkohen nga Kryetari i KLSH.

##### **Paraqitja e dokumenteve**

Kandidatët duhet të paraqesin në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore deri më datë 06 Nëntor 2017 këto dokumente: Letër motivimi për aplikimin në vendin vakant, CV-në, kopje të diplomës së shkollës së lartë dhe të kualifikimeve pasuniversitare, kopje e listës së notave dhe librezës së punës të gjitha të noterizuara, fotokopje e letërnjoftimit, rekomandime nga punëdhënësit e mëparshëm, dëshmi penaliteti, dokumente të tjera (nëse ka), që i çmon se mund t'i vlejnjë për vlerësimin e përgatitjes arsimore dhe profesionale, si dhe dëshmi të zotërimit të gjuhëve të huaja.

##### **Konkurrimi**

Konkurrimi do të bazohet në njohuritë për Kushtetutën, ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ligjin nr. 152/2013, "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar, ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", "Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të KLSH", "Standardet e kontrollit të KLSH" dhe "Standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t, mbi njohuritë dhe të dhënat që jepen në serinë e botimeve të KLSH-së 2012-2016, si dhe në faqen zyrtare të KLSH-së në internet".

Në faqen zyrtare të Kontrollit të Lartë të Shtetit [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al), më datë 09 Nëntor 2017 do të shpallet lista e verifikimit paraprak të kandidatëve, si dhe datat e zhvillimit të konkurrimit.

**Kontrolli i Lartë i Shtetit**